



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Drejtësisë - Ministarstvo Pravde - Ministry of Justice

Kabineti i Ministres së Drejtësisë - Ured Ministarke Pravde - Office of the Minister of Justice

Nr. 32 /2021

Datë: 24 / 03 2021

Në mbështetje të nenit 10 (paragrafi 1 dhe 2) dhe nenit 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funksonimin e Administratës Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7/01 mars 2019) si dhe duke u bazuar në nenin 8 (paragrafi 1.4) dhe nenin 19 (paragrafi 1, nën paragrafi 1.1) të Rregullores (QRK) - Nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive (08.06.2020) e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) - Nr. 07/2020, Ministria e Drejtësisë, nxjerr:

V E N D I M

1. Znj. Nazlie Bala, emërohet Këshilltare Politike e Ministres së Drejtësisë.
2. E emëruara nga pika 1 e këtij vendimi ushtron përgjegjësitë e saj në pajtim me dispozitat përkatëse të Rregullores (QRK) - Nr. 06/2020 për fushat e përgjegjësisë administrative të zyrës së kryeministrit dhe ministrive (08.06.2020) e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren (QRK) - Nr. 07/2020.
3. Mandati i të emëruarës në pikën 1 të këtij vendimi fillon me datë 23.03.2021 dhe zgjatë deri kur pushon mandati i Ministres së Drejtësisë, përkatësisht derisa të mos merret ndonjë vendim tjetër.
4. Të ardhurat personale të të emëruarës nga pika 1 e këtij vendimi do të paguhen në vlerën prej 600.60 euro në muaj.
5. Ky vendim hyn në fuqi në datën e nënshkrimit.



Vendimi i dërgohet:

- Të emëruarës Znj. Nazlie Bala;
- Kabinetit të Ministrit;
- Sekretarit të Përgjithshëm;
- Departamenti për Financa dhe Shërbime të Përgjithshme;
- Divizionit për Burime Njerëzore;
- Divizionit për Buxhet dhe Financa dhe
- Arkivit të Ministrisë së Drejtësisë.